



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 89, datë 25.03.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar dhe në Rregulloren "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Znj. Arta Marku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Znj. Arta Marku do të ushtrojë funksionin e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, përkohësisht nga data 01.04.2020 - 30.06.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Arta Marku do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë së Apelit Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Znj. Arta Marku, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VITË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURRIAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ